



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

LEGJISLATURA V
Sesioni pranveror

Komisioni për Bujqësi, Pylltari dhe Mjedis e Planifikim Hapësinor
Mbledhja nr. 20
Prishtinë, më 29.7.2015, ora 13:00
Ndërtesa e Kuvendit, salla N-302

PROCESVERBAL
I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR BUJQËSI, PYLLTARI DHE MJEDIS E
PLANIFIKIM HAPËSINOR

Në mbledhje morën pjesë: Fikrim Damka, Emilija Redzepe, Haxhi Shala, Adem Salihaj, Salih Salihu, Murat Hoxha, Shaip Muja.

Munguan: Srdjan Popovich, Lahi Brahimaj.

Të ftuar dhe pjesmarrës të tjerë: Sipas listës së nënshkrimeve.

Stafi mbështetës i komisionit: Bajram Badivuku, Ylber Sherifi, Dalina Kërqeli.

Mbledhjen e kryesoi Fikrim Damka, kryetar i komisionit.

Për këtë mbledhje u propozua ky rend dite:

1. Miratimi i rendit të ditës ,
2. Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes së komisionit, të mbajtur më 14.7.2015,
3. Shqyrtimi i projektligjit për rregullimin e shërbimeve të ujit,
4. Të ndryshme

Kryesuesi konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe hapi mbledhjen me pikën e parë të rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua pa ndryshime.

2. Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 14.7.2015

Procesverbali u miratua pa vërejtje.

3. Shqyrtimi i projektligjit për rregullimin e shërbimeve të ujit

Fikrim Damka – kryetar i komisionit, përshëndeti dhe prezantoi pasqyrën e punës së grupit punues ku janë pranuar disa vërejtje me shkrim dhe është sugjeruar të mblidhen vërejtjet tjera nëse ka, sidomos nga Salih Salihu dhe anëtarët tjerë të komisionit.

Shaip Muja rreth shkresës së SHUKOS-it (shoqata e ujërave) për ulje të tarifës tha se duhet të shikohet një qëndrueshmëri stabile dhe pse mos të bëhet një dëgjim me operatorët që janë, ndërsa kryetari **Fikrim Damka** tha se ky projektligj ende nuk ka përfunduar dhe shqyrtimet do të vazhdojnë. Ai sugjeroi që pasi të dorëzohen vërejtjet edhe nga Salih Salihu, stafi të rregulloi vërejtjet me shkrim në kolona, në mënyrë që komisioni të hartoi amendamentet të cilat në fund do të shqyrtohen përfundimisht nga komisioni në ndonjë bashkëtakim me operatorët apo në mënyrën tjetër të duhur. **Salih Salihu** kërkoi falje për vonesën ngase nuk ka qenë në Kosovë por edhe ka deshtë që të jetë prezent për shkak të punës efikase, përndryshe ka mundur me i dërgua komisionit, ai premtoi se do të prezantoi në GP të premtën për ti prezantuar vërejtjet. **Adem Salihaj** shprehu habinë pse tani këto diskutime bëhen kur dihet se vet ky komision ka hartuar këtë ligj. **Baton Begolli** tha se ky “kushllus” ka ndodhur ngase ligji është dërguar nga ky komision në Qeveri të cilët e kanë përcjell gabimisht në një departamenti tjetër për mendim, ndaj në fund të afatit kanë thënë (janë detyruar me thënë) **ne nuk kemi komente-vërejtje**. **Adem Salihaj** vazhdoi dhe rikonfirmoj që ky komision lidhur me tarifa për bazë ka marr inkasimin e jo faturimin, ngase është më reale. **Shaip Muja** diskutoi edhe për disa çështje të cilat duhet ti rregulloi ligji (licencat e prodhuesve, të shihet në praktikë si duket një ligj për ujërat e zeza etj), pastaj të përfundoi amendamentimi, për çka u interesua edhe përfaqësuesja nga ZRRUK. **Salih Salihu** u bashkëngjiti duke shtuar se duhet të shikohet edhe shfrytëzimi eficientë i ujit duke pasur parasysh përvojat nga shtetet e rajonit. Në tavolinë anëtarët e komisionit para vedi kishin vërejtjet me shkrim të dërguara nga Baton Begolli si vijon :

Amendamenti 1

Në tërë tekstin e Projektligjit të zëvendësohen fjala “**Rregull**” me “**Rregullore**”, “**Kyçje**” me “**Lidhje**” dhe “**Shkyçje**” me “**Ndërprerje**”.

Amendamenti 2

Neni 1, në rreshtin e 4 fshihet togfjalëshi “**në pronësi publike**”

Amendamenti 3

Neni 3, fshihet paragrafi 1.7, poashtu fshihet paragrafi 1.27.

Riformulohet paragrafi 1.28, si vijon: “**Ndërprerje - ndërprerje e ofrimit të shërbimeve nga ofruesi i shërbimeve për shkaqe të sigurisë, operationale, mospagesës së faturave nga ana e konsumatorit apo për shkaqe tjera të përcaktuara me këtë ligj**”.

Amendamenti 4

Neni 5, paragrafi 2, në fund shtohet togfjalëshi “**dhe të miratuar nga komisioni parlamentar përkatës**”.

Amendamenti 5

Neni 7, paragrafi 6, të rishikohet mandati i drejtorit dhe zëvendës drejtorit.

Amendamenti 6

Neni 14, paragrafi 3 të riformulohet si vijon: “**Autoriteti, pas aprovimit të buxhetit vjetor nga Kuvendi i Republikës së Kosovës, nxjerr Udhëzim Administrativ për lartësinë e taksës së licencimit të cilat duhet t’i sigurojnë të hyra të mjaftueshme Autoritetit për realizimin e buxhetit të aprovuar.**”

Amendamenti 7

Neni 16, paragrafi 3 riformulohet si vijon: “**Autoriteti shqyrton aplikacionin për lëshimin ose përtëritjen e licencës për shërbime brenda afatit prej katërdhjetë e pesë (45) ditëve të punës pas marrjes së aplikacionit. Vendimi lidhur me aplikacionin nxirret pas këtij afati me kusht që të gjitha informatat dhe dokumentet e kërkuara për të marrë vendimin i janë sjellë nga ofruesi i shërbimeve.**”

Amendamenti 8

Neni 17, paragrafi 1 të diskutohet afati i licencave prej 1- 10 vjet

paragrafi 2.3 të plotësohet në fund me fjalët “**të përcaktuara me politikat dhe planet e Qeverisë për konsolidimin e ofruesve të shërbimeve**”.

Amendamenti 9

Neni 18, Paragrafi 1, në fillim pas fjalës “**Autoriteti**” shtohet togfjalëshi “**në harmoni me ligjin**” dhe vazhdon teksti

Amendamenti 10

Neni 20, paragrafi 3.5 dhe 4 të fshihen.

Amendamenti 11

Titulli i kapitullit të IV, riformulohet si vijon: “**Standardet e Shërbimit**”.

Amendamenti 12

Neni 28, paragrafi 3.1 dhe 3.3. të caktohen afatet

Paragrafi 3.7 në fund “**“datën e pagesës”** zëvendësohet me “**në afatin e paraparë**”

Paragrafi 3.8. togfjalëshi “**në mënyrë të pandershme**” zëvendësohet me “**në kundërshtim me kartën e Konsumatorit**”

Amendamenti 13

Neni 38, fjala “**mbikëqyrëse**” zëvendësohet me “**monitoruese**”

Amendamenti 14

Pas nenit 47 të shtohet neni i ri, si vijon: (propozim Baton Begolli)

Pronësia e aseteve të Ofruesve të Shërbimit të Ujit

1. Të gjitha asetet e sistemeve të cilat shërbejnë për ofrimin e Shërbimeve të Ujit të cilat menaxhohen nga një Ofrues i licencuar i Shërbimeve të Ujit të cilat janë në pronësi publike por që nuk janë të regjistruara në regjistrin e aseteve të atij Ofruesi të Shërbimeve duhet të regjistrohen si asete në pronësi të atij Ofruesi të Shërbimeve.

2. Për pronat tokësore në të cilat janë ndërtuar objektet e sistemeve të shërbimeve të ujit apo pronat tokësore të cilat janë përcaktuar si zona e parë e mbrojtjes së një burimi i cili shfrytëzohet për shërbimet e ujit e të cilat nuk janë në pronësi të Ofruesit të Shërbimeve të Ujit që menaxhon ato sisteme në bazë të licencës së lëshuar nga Autoriteti, duhet që Ofruesi i Shërbimeve të iniciojë procedurën e shpronësimit në pajtim me ligjin.

Propozime shtese nga Baton Begolli

- Neni 3, paragrafi 1.12 të riformulohet: **Licencë e shërbimit** – leje e lëshuar nga Autoriteti me të cilën jepet autorizimi për ofrimin e shërbimit të ujit;
- Neni 3, paragrafi 1.13 të riformulohet: **Marrëveshje për pagesë** – marrëveshje e lidhur ndërmjet ofruesit të shërbimeve të ujit dhe konsumatorit për pagesë të borxhit që ka konsumatori ndaj ofruesit të shërbimeve;
- Neni 3, paragrafi 1.23 të riformulohet: **Shërbimet e ujërave të ndotura** - grumbullimi, bartja, trajtimi dhe shkarkimi i ujërave të ndotura të përdorura nga shfrytëzuesit shtëpiak, komercial, industrial dhe publik;
- Neni 3, paragrafi 1.24 të fshihet meqë është pjesë e kufizimit paraprak.
- Neni 3, paragrafi 1.35 të riformulohet: **Zona e shërbimit** - rajoni ose komunat në të cilën ofruesi relevant i shërbimeve mund të ofrojë shërbimet e tij në bazë të licencës së shërbimit
- Neni 20, paragrafi 2, të fshihen fjalët “i miraton ato ose ndonjë ndryshim të tarifave të ofruesit të shërbimeve apo furnizuesit të ujit të papërpunuar”.
- Neni 21, paragrafi 2.1.5 të riformulohet në “afatin për zgjidhjen e ankesave dhe për trajtimin e kërkesave për lidhje në sistemin e ujësjellësit dhe shërbimet e ujit”.
- Kapitulli V të riformulohet në Të Drejtat dhe Obligimet e Konsumatorëve.
- Neni 26, të shtohet paragraf i ri (3) para paragrafit 4: Anëtarë të një Komisioni Këshillues të Konsumatorëve janë përfaqësuesit e komunave të cilat janë në kuadër të asaj zone të shërbimit dhe ata emërohen nga Autoriteti në bazë të propozimit të komunave përkatëse.

Mbledhja përfundoi në ora 13:45

Përgatitur nga:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit

Kryetari i Komisionit,

Fikrim Damka